



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
JURIA

Nr. 49/1 Prot.

Tiranë, më 03.02.2026

Vendim nr. 15 datë 03.02.2026

Për dhënien e mirënjohjes *Nderi i Akademisë*

Prof. Priamo Bollanos

Referuar nenit 10 të *Rregullores për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre*; në mbështetje të Vendimit të Kryesisë nr. 19 datë 24.05.2022 *Për mirënjohjen "Nderi i Akademisë" dhe për kriteret e procedurat e dhënies së saj*; me propozim të komisionit të përhershëm të ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike, në shkresën me nr. prot. 47, datë 12.01.2026 (bashkëngjitur) dhe shkresën e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike me nr. prot. 49, datë 12.01.2026 (bashkëngjitur); pasi konstatoi plotësimin e kriterëve dhe zbatimin e procedurave sipas parashikimeve si më sipër; Juria, në mbledhjen e saj të datës _____.____.2026,

Vendosi:

1. T'i jepet mirënjohja *Nderi i Akademisë* personalitetit të shquar në fushën e shkencave ekonomike:

- Prof. Priamo Bollano

Me motivacionin:

Për rolin thelbësor në modernizimin e arsimit në fushën e shkencave ekonomike, forcimin e metodologjisë shkencore dhe etikës profesionale në institucionet e arsimit të lartë, administratën publike, institucionet kërkimore-shkencore, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e brezave të ekonomistëve dhe studiuesve. Punimet e tij përbëjnë sot një fond të çmuar reference për historinë dhe evolucionin e mendimit ekonomik në Shqipëri, për promovimin e ekonomisë si shkencë

shoqërore, të lidhur ngushtë me drejtësinë, përgjegjësinë publike dhe integritetin profesional. Figura e tij përfaqëson modelin e intelektualit që e sheh dijen si mision shërbimi ndaj shoqërisë e shërben si një mesazh frymëzues për brezat e rinj. Përkushtimi afatgjatë i prof. Bollanos ndaj dijes dhe etikës, mbetet standardi më i lartë i suksesit akademik e institucional.

3. Mirënjohja Nderi i Akademisë t'i jepet përmes një ceremonie të organizuar sipas përshkrimit në Rregulloren për ceremonialin dhe solemnitetet, në aktivitetin që do të organizohet me rastin e 90-vjetorit të lindjes së prof. Priamo Bollanos në ambasadën e Republikës së Shqipërisë, në Athinë, Greqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetari i SSHSHA, kancelari e Sektori i marrëdhënieve me jashtë dhe publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

